



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE
DREJTORIA TEKNIKE

RELACION
Mbi
Hapjen e ankandit publik të njësive të shërbimit të Banesës në Sarandë

Pershkrimi

Ne qytetin e Sarandës është ndërtuar me fondet e EKB-së një banesë me 28 apartamente dhe një kat lokale shërbimi në katin përdhe.

Objekti është ndërtuar në Rrugën "Butrinti" Sarandë, Zona kadastrale 8642 me Nr. pasurie 18/349, në një zonë e cila është e formuluar me ndërtime të reja, dhe një pozicion të favorshëm në raport me rrugën.

Ekzistenca e Lokaleve në katin përdhe ka përcaktuar vijën e ndërtimit dhe e ka bërë më urbane dhe me njerëzore pjesën e rrugës duke i dhënë kësaj një dimension tregëtar që është mjaft i nevojshëm për zonën.

Arkitektura e objektit Banesë tip 83/5, 8 kate është e thjeshtë, një arkitekture banimi me një fasadë me suva dhe bojë plastike. Banesa është e paisur me ashensor.

Kati përdhe është projektuar me 3 njësi shërbimi, punimet kanë përfunduar plotësisht. Janë përfunduar të gjitha punimet e rifinitures, si shtresat, suvatimet dhe bojatisja, dyer, vetrata, është kompletuar edhe ambienti i tualetit me paisjet hidro sanitare. Punimet e kryera janë të një cilësie të mirë.

Dyshemeja e katit përdhe është e hidroizoluar me dy shtresa guajn dhe e shtruar me pllaka qeramike cilësi e parë.

Eshte realizuar rrjeti rrufeprites, togezimi .

Për katin përdhe lokal sherbimi jane realizuar hyrjet e daljet me rampa te veçanta .

Shkallët janë veshur me pllaka mermeri.

Objekti ka këto kondicione urbane:

Lartesia e pergjithshme e godines eshte 28.34 meter
Numri i kateve 8,
Distanca e volumit nga aksi i rruges eshte 15 m
Distanca e volumit nga rruga eshte 8 m
Siperfaqe e ndertimit (Truall+ Trotuar) eshte 416 m2
Nr.i njesive te sherbimit eshte 3

Ambjenti perreth objektit deri ne lidhjen me rrugen eshte i sistemuar

Objekti eshte i lidhur me infrastrukturen inxhinierike FU, FEE, KUZ.

Pershkrimi i katit perdhe sipas faktit

Siperfaqja totale e ndertimit te njesive te sherbimit **306 m2**

Siperfaqet sipas lokaleve

Lokali	Sip.ndertimi m2	
Njesia 1	120 m2	
Njesia 2	56 m2	
Njesia 3	130 m2	
Totali i sip.te ndertimit te lokaleve ne k.perdhe		306 m2

Me Vendim te Keshillit Drejtues te EKB-se Nr 11 date 28/05/2015 eshte miratuar çmimi dysheme i hapjes se ankandit publik, per te realizuar shitjen e lokaleve ne katin perdhe ne vleren **700 Euro/m2(shtateqind) Euro / m2 .**

Bashkelidhur ketij informacioni do gjeni:

- 1-Planimetrine e sheshit te ndertimit
- 2- Planimetria e katit perdhe lokal sherbimi.
- 3 – Planimetrite e cdo njesie sherbimi shk.1:100
- 3- Kopje te certifikatave te pronesise
- 4- Kopje te Vendimit te Keshillit Drejtues te EKB Nr 11, date 28/05/2015

Dokumentacioni i mesiperm sherben per hapjen e ankandit publik te shitjes se njesive te sherbimit ne katin perdhe te baneses me 8 kate me 28 apartamente dhe nje kat lokale sherbimi te ndertuar me fondet e EKB-se ne qytetin e Sarandes, Rruga butrint.

Drejtoria Teknike